



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:052382

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06379279

Kom.Dh.Shk.II.nr.1323/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Franciska Zhitija - Ymeri, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Louis Vuitton Malletier me seli në Francë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Samiri Tours Sh.P.K., me numër unik identifikues 810842783 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Besim Curri, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.159/2023, të datës 02.04.2024, me datë 24.10.2024, mori këtë;

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e paditësit “Louis Vuitton Malletier” me seli në Francë dhe të paditurit Samiri Tours Sh.P.K., me numër unik identifikues 810842783 dhe seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.159/2023, i datës 02.04.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar KE.nr.159/23 të datës 02.04.2024, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vepruar si gjykatë e shkallës së parë, sipas padisë së paditësit Louis Vuitton Malletier me seli në Francë, kundër të paditurit Samiri Tours Sh.P.K., me numër unik identifikues 810842783 dhe seli në Prishtinë, në objektin e kontestit shkelje e markës tregtare, ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Louis Vuitton Malletier dhe VËRTETOHET se i padituri Samiri Tours Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me datë 17.10.2022, përmes importimit të 6 copë jakne për të rritur, ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit “Louis Vuitton Malletier”.

- II. I NDALOHET të paditurit që në të ardhmen të ndërmarrë çfarëdo veprimi me të cilin mund të shkelen të drejtat e pronësisë intelektuale të paditësit në çfarëdo mënyre, përfshirë importimin që përmbajnë elemente identike apo të ngjashme me markat tregtare të regjistruar të paditësit.
- III. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë, me të cilën paditësi Louis Vuitton Malletier ka kërkuar që të detyrohet i padituri Samiri Tours SH.P.K., që paditësit t'ia paguaj shumën prej EUR 12.00 në emër të shkatërrimit të mallrave si dhe shumën EUR 5,000.00 në emër të gjobës për shkeljen e markës tregtare të paditësit në rastin e iniciuara nga Dogana e Kosovës sipas numrit 418-2022.
- IV. DETYROHET i padituri që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej EUR 798.80 (shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë Euro e tetëdhjetë Cent), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës të Ligjit mbi Markat Tregtare, Ligjit mbi masat doganore për mbrojtjen ee të drejtave të pronësisë intelektuale dhe Ligjit për Procedurën kontestimore; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e të paditurit si e bazuar, të anulohet aktgjykimi me numër KE.nr.159/23 e datës 03.04.2024, ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit Louis Vuitton Malletier, si e pabazuar.

Kundër aktgjykimit ankesë ka parashtruar edhe paditësja, duke e atakuar vetëm pikën III të aktgjykimit për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit ashtu që të ndryshohet pika III e aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.159/2023, i datës 02.04.2024, ashtu që të vendoset si në vijim: OBLIGOHET i padituri Samiri Tours SH.P.K., që paditësit t'ia paguaj shumën prej EUR 12.00 në emër të shkatërrimit të mallrave si dhe shumën EUR 5,000.00 në emër të gjobës për shkeljen e markës tregtare të paditësit në rastin e iniciuara nga Dogana e Kosovës sipas numrit 418-2022.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Paditësi Louis Vuitton Malletier përmes të autorizuarit të tij, me datën 22.02.2023, ka paraqitur padi pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, për shkelje të markës tregtare kundër të paditurit Samiri Tours SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit, ashtu që të vërtetohet se i padituri ka shkelur markat tregtare të paditësit, t'i ndalohet të paditurit që në

të ardhmen të importoj apo në çfarëdo forme të tregtoj me mallra që shkelin markat tregtare të paditësit, të obligohet i padituri që t'ia kompensoj të gjitha shpenzimet e shkatërrimit të mallrave për rastin e iniciuar nga Dogana e Kosovës me numër 418-2022, të obligohet i paditurit që të zbuloj informacione për origjinën dhe shpërndarjen e produkteve të cilat shkelin markat tregtare të paditësit, të obligohet i padituri që paditësit t'ia paguaj shumën prej EUR 5,000.00 në emër të ndëshkimit për shkelje të markës tregtare sipas rastit nr. 418-2022, të obligohet i padituri që me shpenzimet e tij të publikoj në mjetet e informimit publik këtë aktgjykim. Ndërsa përfaqësuesja e paditësit, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 15.02.2024, ka zvogëluar kërkesëpadinë duke i propozuar gjykatës së shkallës së parë që të merr aktgjykim me të cilin vërtetohet se i padituri ka shkelur markat tregtare të paditësit; t'i ndalohet të paditurit që në të ardhmen të importoj apo në çfarëdo forme të tregtoj me mallra tregtare që shkelin markat tregtare të paditësit; të obligohet i padituri që paditësit të ia kompensojë shpenzimet e shkatërrimit të mallrave për rastin nr. 418-2022 si dhe të obligohet i padituri që paditësit të ia paguaj shumën prej EUR 5,000.00 në emër të ndëshkimit sipas nenit 75.4 të Ligjit për markat tregtare.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, konkretisht si në dispozitivin e aktgjykimit. Deri te ky vlerësim gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim pasi që ka konstatuar se shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit. Konstatimin e tillë gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur në dispozitat e nenit 4.1, dhe 9 të LMT, pasi që ka konstatuar se në rastin konkret, është provuar se i padituri ka importuar mallrat kontestuese pa autorizimin e paditësit si bartës i të drejtave nga marka tregtare e regjistruar "Louis Vuitton Malletier.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, para. 2, nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e shkallës së dytë pas vlerësimit të pretendimit ankimor të autorizuarit të palës së paditur, në lidhje me faktin se malli nuk është importuar por vetëm ka aplikuar për import – gjë që nuk gjen zbatim LMT, për Kolegjin nuk paraqet pretendim ankimor të bazuar për të vendosur ndryshe. Kjo për faktin se me Nenin 9 të LMT pronari i markës tregtare gëzon mbrojtje duke iu mundësuar edhe e drejta e ndalimit të vendosë mallin me markën e mbrojtur, përfshirë këtu importin, transitin etj. Pra është evident fakti se nuk nënkupton medoemos se paditësi ka pasur të drejtë të gëzojë mbrojtje vetëm me faktin e vendosjes së produktit në treg apo kryerjen e importit por edhe ndalimin para se produkti të importohet. Rrjedhimisht, pretendimet ankimore të paditurës se malli është ndaluar në kufi para importimit, nën pretekstin se gjykata e shkallës

së parë ka konstatuar “vënien në qarkullim të produkteve” nuk ndryshon gjendjen faktike e as nuk i jep të drejtë të paditurës në një vendim ndryshe. Sipas Kolegjit, aspektet procedurale të mënyrës së vënies së produktit në treg, qoftë përmes importit apo deri në fazën e importit nuk bëjnë ndryshim në gëzimin e të drejtave absolute të markave tregtare.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, ngase bazuar në provat përkatëse të lëndës ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të të paditurit lidhur me konstatimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë për faktin se në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se i padituri në mënyrë të paautorizuar ka bërë futjen e mallit në fjalë në territorin e Republikës së Kosovës, i cili mall ka përmbajtur në vete markën tregtare të paditësit të regjistruar në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë e këtij veprimi, i padituri ka shkelur të drejtën e markës tregtare të paditësit.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT), i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund të ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Sa i përket pretendimeve ankimore të palës paditëse me të cilën është goditur pika III e aktgjykimit, Kolegji vlerëson se pavarësisht trajtimit të kërkesës për gjobë në raport me dëmin, një gjë e tillë nuk nënkupton se gjykata e shkallës së parë ka trajtuar kërkesën për gjobë si kërkesë kompensuese. Përkundrazi, kërkesa për gjobë është refuzuar nën pretekstin se pala paditëse nuk ka pësuar ndonjë dëm, e i cili do të ishte justifikim i vënies së gjobës. Ndonëse në përshkrimin e çështjes gjykata ka theksuar se paditësit nuk i është shkaktuar dëm, kjo nuk nënkupton se është refuzuar kërkesa për kompensim dëmi, por që shqiptimin e gjobës gjykata e ndërlidh me pasojat dëmtuese të cilat e justifikojnë masën e gjobës vënies. Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjoba nga neni 75.4 i LMT është përcaktuar si masë parandaluese për shkeljet eventuale që mund të vazhdojë. Prandaj, që masa e tillë të caktohet, do të duhej të i shërbejë një qëllimi legjitim që të ndalojë përsëritjen apo dëmin eventuale dhe nuk mund të caktohet me automatizëm nga gjykata. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar dëmin si kusht për caktimin e gjobës, e që Kolegji vlerëson se me të drejtë masa e tillë është përsëritur dhe atë për arsye se shkelja është kryer nga një palë e tretë që vetëm ka transportuar mallra, ndërkaq masat e caktuara janë të mjaftueshme për arritjen e qëllimit të mbrojtjes së markës tregtare.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovojnë edhe Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale .

Nga sa u tha më lartë, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 para. 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë,
Kom.Dh.Shk.II.nr. 1323/2024, me datë 24.10.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova